

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **231-26-2483-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: **“Shtypja e botimeve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës”**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Ndermarria Tregtare Grafike BLENDI O.P

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gustav Maier, Nr. 13

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

(Kodi postar)

044123934

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Blend Rama

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

E-mail adresa

prokurimi.ntgblend@gmail.com

Data: 03.06.2026

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- **Njoftimi për kontrate: 20.04.2026**
- **Hapja e ofertave: 12.05.2026**
- **Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët**
- **Kërkesa për ri-shqyrtim 23.05.2026**
- **Vendimi për refuziminn e kërkesës për ri-shqyrtim 25.05.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

PRETENDIMI NJË

Neni 1 Qëllimi

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

PRETENDIMI DY

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

PRETENDIMI TRE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

PRETENDIMI KATËR

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

PRETENDIMI PESË

Neni 60

Kriteret për Dhënien e Kontratës

51 1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI I PARË :

Neni 1 Qëllimi i LPP-së:

Autoriteti kontraktues, gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, nuk ka vepruar në përputhje me qëllimin dhe parimet themelore të përcaktuara në nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke cenuar parimet e profesionalizmit, paanshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë për operatorët ekonomik konkurrues dhe shfrytëzimit efikas e ekonomik të fondeve publike, të cilat përbëjnë bazë thelbësore të këtij ligji.

Autoriteti kontraktues nuk iu është përmbajtur detyrimit për të zhvilluar një procedurë të drejtë, transparente dhe të paanshme, mirëpo ka krijuar rrethana që kanë dëmtuar konkurrencën e dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Përmes veprimeve të ndërmarra, autoriteti kontraktues ka devijuar nga standardet ligjore dhe procedurale që synojnë garantimin e integritetit dhe besueshmërisë së procesit të prokurimit publik.

Këto veprime janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me frymën dhe qëllimin e nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili obligon autoritetet kontraktuese që fondet dhe burimet publike të administrohen **në mënyrë efikase**, ekonomike, transparente dhe të drejtë, duke iu përmbajtur në mënyrë rigoroz procedurave dhe kushteve

ligjore. Rezultati I AK-së, me këto shkelje, ka cenuar ligjshmëria e procedurës së prokurimit dhe janë dëmtuar interesat legjitime për ne si operator ekonomik konkurrues, duke e

rekomanduar një operator ekonomik për kontratë me cmim më të lartë dhe pa asnjë kusht tjetër kualifikues (më superior) në raport me ne si operator i përgjegjshëm me cmim më të ulët.

Të njëjtën kohë autoritet kontraktues ka bërë shkelje edhe të nennit 60 te kriteret për dhënje të kontratës, duke shkelur kriterin kryesor dhe primar i procedurës së prokurimit nenin 60 kriteret për dhënje(cmimi më i ulët).

Rekomandimi i operatorit ekonomik me cmim më të lartë dhe pa asnjë bazë ligjore dhe duke e arsyetuar mbi bazën e një kërkesë të paqenë dhe e pakualifikuar si kërkesë në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë në vetvete përmban elemente diskriminuese dhe favorizuese për një operator ekonomik të caktuar,

Ne si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë të përgjegjshëm me cmimin më të lirë nuk jemi trajtuar ligjërisht dhe në mënyrë të barabartë si operatori tjetër ekonomik dhe për këtë kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe nga Paneli i OSHP-së ti ta trajtojnë arsyen e eliminimit tonë nga Autoriteti Kontraktues, ku në atë arsye mund të verifikohen të gjitha shkeljet të cilat i ka bërë autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit tonë, duke na eliminuar me një arsye pa qenë kërkesë e autoritetit kontraktues në dojse të tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe duke e rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik me cmim më të lartë se sa oferta jonë.

Arsyeja e eliminimit është:

Moastrat e juaja janë ofruar nga veprimtaria juaj botuese dhe jo sipas kërkesave të ASHAK.

Ne kemi kërkuar qasje në dokumentat e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, Dhe ju sqaroj se asnjë element në listën e cmimeve të ofruar nuk e ka ofruar ndryshe nga ne, pasi që edhe një herë e potencoj se nuk ka pasur kërkesë as në dosje të tenderit dhe as në njoftimin për kontratë se me cilën prejardhje duhet të jenë mostrat apo diqka e e ngjajshme, andaj ky veprim i Autoritetit kontraktues është në kundërshtim me **LPP-në përkatësishtë nenin 40 paragrafi 40.2.**

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe **kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit** dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.

PRETENDIMI I DYTË:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti i LPP-së:

Autoriteti Kontraktues, me rastin e marrjes së vendimit për dhënie të kontratës, ka rekomanduar operatorin ekonomik me ofertë më të lartë financiare se oferta e paraqitur nga ne si operatori ekonomik, pa ofruar arsytim të mjaftueshëm ligjor, faktik dhe profesional lidhur me refuzimin e ofertës sonë dhe **përzgjedhjen e ofertës më të shtrenjtë.**

Një veprim i tillë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik, i cili obligon autoritetet kontraktuese që fondet dhe burimet publike ti përdorin në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar se rekomandimi i operatorit ekonomik me çmim më të lartë siguron përfitim më të madh publik apo vlerë më të favorshme për fondet publike.

Përkundrazi, vendimi i kontestuar rezulton në rritje të panevojshme të kostos së kontratës dhe cenon parimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe menaxhimit racional të parasë publike.

Për më tepër, mungesa e një arsytimi të qartë dhe bindës mbi eliminimin/refuzimin e ofertës sonë dhe favorizimin e një oferte më të kushtueshme krijon dyshime serioze mbi respektimin e parimeve themelore të prokurimit publik, përfshirë trajtimin e barabartë, proporcionalitetin, transparencën dhe konkurrencën e drejtë. Rrjedhimisht, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është i kundërligjshëm dhe si i tillë duhet të anulohet.

PRETENDIMI I TRETË:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti Kontraktues, në këtë zhvillim të aktivitetit të prokurimit, ka vepruar në kundërshtim me Nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik, duke mos respektuar parimin e barazisë në trajtim dhe jo-diskriminimit ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Veprimet e tij nuk garantojnë trajtim të njëjtë, transparent dhe të paanshmëri për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë, duke krijuar avantazh të pajustificuar për një operatorë të caktuar dhe duke na vendosur në pozitë të pafavorshme ne si operatorë konkures.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë veprime duke të kundërligjshme në mënyrë të drejtpërdrejtë duke deformuar konkurrencën e hapur ndërmjet neve si operatorëve ekonomikë dhe operatorin e rekomanduar për kontratë.

Një qasje e tillë, përveçse cenon parimin e konkurrencës së lirë, krijon dyshime të arsyeshme për favorizim apo diskriminim në procesin e prokurimit.

Rrjedhimisht, konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me **Nenin 7 të LPP-së** dhe si të tilla cenojnë rëndë integritetin e procedurës së prokurimit.

PRETENDIMI I KATËRT:

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Autoriteti Kontraktues, gjatë zhvillimit të procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik, duke mos respektuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë kërkesat ligjore për një vlerësim objektiv, të saktë dhe të barabartë në mes të ofertës sonë dhe ofertës të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Në rastin konkret, ekziston dyshimi i bazuar se ekzaminimi dhe vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, duke rezultuar në trajtim jo të njëjtë të operatorëve ekonomikë dhe në devijim nga parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Po ashtu, krahasimi i tenderëve nuk është realizuar në mënyrë të drejtë dhe objektive, duke favorizuar operatorë të caktuar dhe duke dëmtuar konkurrencën e hapur.

Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe bindëse vendimin e për refuzimin e ofertës sonë dhe përzgjedhjen e një oferte tjetër, duke mos ofruar prova të qarta se vlerësimi është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara paraprakisht.

Një veprim i tillë cenon rëndë integritetin e procesit të vlerësimit dhe bie ndesh me kërkesat e Neni 59, i cili obligon autoritetin kontraktues që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në mënyrë profesionale, transparente dhe të paanshme.

Në arsyen e eliminimit tonë mund të shihni se arsyetimi nuk është në pajtim me nenin përkatës. Arsyeja e eliminimit është e përgjithësuar jo proporcionale me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë poashtu është bërë në një mënyrë apo tjetër mbi bazën e një kërkesë të paqenë vetëm e vetëm për të na eliminuar ne si operator ekonomik të përgjegjshëm me cmim më të lirë.

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

- *Mostrat e dorëzuara janë nga veprimtaria e juaj botuese dhe jo sipas kërkesave të ASHAK-ut*

. Pas qasjes në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, sqarojmë se te lista e cmimeve nuk ka ofruar asgjë tjetër nga përshkrimi i cmimit është vetëm i vulosur dhe i nënshkruar, andaj kjo është një tendencë e hapur për ne si operator ekonomik duke provuar që të na eliminoni pa asnjë arsye legjitime por vetëm në mënyrë fiktive.

Poashtu sqaroj se autoriteti kontraktues në arsyen e eliminimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 42 paragrafi 42.3 duke mos e afruar arsyetimin e nevojshëm siq kërkohet në nenin 42.3 ku tenderuesit duhet ti ofrohen arsyetimet e nevojshme.

42.3 Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat standarde përkatëse për Tenderuesit me arsyetimet e nevojshme.

PRETENDIMI I PESTË:

Autoriteti Kontraktues, me rastin e dhënies së kontratës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat imperative të Nenit 60 të Ligjit për Prokurim Publik, i cili përcakton qartë se kontrata publike duhet t'i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**, kur ky kriter është i përcaktuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Në rastin konkret, operatori ynë ekonomik ka dorëzuar tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët në krahasim me ofertën e operatorit ekonomik të rekoamnduar për kontratë, duke përmbushur në tërësi kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Megjithatë si Autoriteti Kontraktues, në mënyrë të pajustificuar dhe në mungesë të një arsyetimi të bazuar ligjor dhe faktik, ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator tjetër ekonomik me çmim më të lartë.

Një veprim i tillë përbën shkelje materiale të parimit të dhënies së kontratës sipas kriterit të përcaktuar paraprakisht, duke cenuar drejtpërdrejt parimin e ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë dhe në veçanti, parimin e economicitetit dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike.

Vendimi i AK është i kundërligjshëm, i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 60 të LPP-së, duke imponuar nevojën për anulimin e tij dhe rivlerësimin e ofertave në përputhje të plotë me kriterin e çmimit më të ulët të përgjegjshëm.

Poashtu autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 të LPP-së, paragrafi a. dhe paragrafi c. si në rastin konkret, ku me njoftimin e vendimit të autoritetit kontraktues dhe njoftimit për tenderuesin e eliminuar në arsyet për eliminim, ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 të LPP-së.

Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efektive dhe me efektive.

c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprojë në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

PËRFUNDIM:

I.TË ANULOHET NJOFTIMI PËR DHENJE

II.LËNDA TË KTHEHET NË RI-VLERËSIM

III.DHE NE SI OE PJESËMARRËS TË VLERËSOHEMI ME OFERTËN TONË TË DORËZUAR NË BAZË TË LPP-SË.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke marrë për bazë të gjitha resurset njerëzore të angazhuar dhe pjesa teknike e logjistike dëmet materiale të cilat do të shkaktohen janë rreth 5.000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) Një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.